



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN
Fakulteti Ekonomik – Economics Faculty

UNIVERSITETI-UNIVERSITY
"KADRI ZEKA"
FAKULTETI EKONOMIK

Adresa: Rr. Zija Shemsiu, p.n., 60000 Gjilan, Republika e Kosovës 33
www.uni-gjilan.net, tel. +383 (0) 28039011

Dt. Pranimi 05.02.2024

Duke u bazuar në Rregulloren mbi procedurat e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm – me honorar, në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan, nr ref.01/1473, dt.09.07.2021 dhe kriteret e paraqitura në Konkursin me nr. ref. 01/63, dt.17.01.2024; për angazhim në Fakultetin Ekonomik, në semestrin veror të vitit akademik 2023/24, Komisioni në përbërje: Prof.Ass.Dr.Arben Sahiti, Prof.Ass.Dr. Nexhat Shkodra dhe Prof.Ass.Dr. Lulzim Rashiti, pasi ka shqyrtuar të gjitha aplikacionet dhe pasi, më datë 01.02.2024, ka realizuar intervistat me kandidatët që kanë plotësuar kushtet formalo-juridike, ka përgatitur raportin me rezultatet sipas pozitive të konkursit me arsyetimet përkatëse.

RAPORT I KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK PËR ANGAZHIM NË SEMESTRIN VEROR - VITI AKADEMIK 2023/24 NË FAKULTETIN EKONOMIK

Pozita	Kandidati	Propozimi
1. Një mësimdhënës - për mbajtjen e ligjëratave për lëndët: <i>Auditim dhe Sistemi i Kontrollit</i>	Shefket Jakupi	Komisioni propozon që Prof.Asoc.Dr. Shefket Jakupi, të zgjidhet për këtë pozitë. Kandidati ka qenë profesor i rregullt i Fakultetit Ekonomik deri në vitin akademik që lamë pas, me thirrjen Profesor Asistent. Me një përvojë të gjatë në mësimdhënien universitare, ku përfshihet edhe lënda e shpallura në konkurs, ai i plotëson më së miri kushtet për këtë pozitë.
	Agon Bislimi	Nuk ka marrë pjesë në intervistë.
	Kamer Brahimaj	Nuk ka gradë shkencore Dr.sc.
	Gazmend Morina	Nuk ka marrë pjesë në intervistë.
2. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët: <i>Bazat e statistikës dhe Matematikë financiare.</i>	Shkurte Morina	Komisioni propozon që kandidatja MSc. Shkurte Morina, të zgjidhet për këtë pozitë. Kandidatja i plotëson të gjitha kushtet formalo juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Ajo ka qenë e angazhuar në UKZ-Fakultetin Ekonomik edhe dy vitet e kaluara si dhe semestrin paraprak ku ka mbajtur edhe lëndët e paraqitura në konkurs; ka treguar sukses në mësimdhënie që është dëshmuar edhe nga vlerësimi i studentëve.

		Komisioni, pasi bëri edhe intervistën me kandidaten, erdhi në përfundimin që të njëjtën ta propozoj për këtë pozitë edhe këtë semestër.
	Elina Krasniqi	Kandidatja, Elina Krasniqi, nuk propozohet për këtë pozitë. Ajo i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Kandidatja nuk ka pasur angazhim të mëhershëm të mësimdhënies në nivelin universitar si dhe gjatë intervistës nuk ka qenë në gjendje të ofroj fleksibilitet orari për mbajtjen e ushtrimeve dhe angazhimit në detyrat tjera. Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni në mesin e dy kandidatëve i dha përparësi kandidates së përzgjedhur.
	Kamer Brahimaj	Nuk propozohet për këtë pozitë pasi nuk është nga fusha e Matematikës.
	Mensur Ajeti	Nuk propozohet për këtë pozitë pasi nuk është nga fusha e Matematikës.
3. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët: <i>Menaxhmenti strategjik; Bazat e menaxhmentit; Menaxhimi i Investimeve dhe Analizë e Investimeve.</i>	Fatlind Morina	Komisioni propozon që PhD.Cand. Fatlind Morina, të zgjidhet për këtë pozitë. Kandidatit i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Ai gjithashtu është duke vazhduar studimet e doktoratës në të njëjtën fushë, ndërsa ka pasur angazhime në Fakultetin Ekonomik të UKZ-së edhe në të kaluarën për të gjitha këto lëndë dhe ka treguar performancë të shkëlqyeshme, të vlerësuar nga studentët. Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidati i propozuar është më i përshtatshëm për këtë pozitë dhe ka përparësi në raport me kundër kandidatët.
	Lum Çollaku	Është propozuar në tjetër pozitë.
	Kamer Brahimaj	Kandidati, PhD.Cand. Kamer Brahimaj, nuk propozohet për këtë pozitë. Ai i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Por, pas shqyrtimit të dokumentacionit të të gjithë kandidatëve dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidati i propozuar është më i përshtatshëm për të vazhduar edhe këtë vit në angazhimin për këtë pozitë.
	Mentor Rashiti	Nuk ka marrë pjesë në intervistë.
	Vjosa Hajrullahu Mustafa	Nuk ka marrë pjesë në intervistë.
4. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve	Vedat Zylfiu	Komisioni propozon që kandidati, PhD.Cand. Vedat Zylfiu, të zgjidhet për këtë pozitë. Kandidati

<p>për lëndët në semestrin dimëror:</p> <p><i>Planifikimi dhe Implementimi i E- Qeverisjes; Menaxhimi i Burimeve Njerezore; Ndërmarrësi.</i></p>		<p>është njëri ndër kandidatët që i plotëson më së miri kushtet për këtë pozitë, duke marrë për bazë kushtet formalo-juridike, për sa i takon fushës së studimit dhe notës mesatare. Ai është në përfundim të studimeve të doktoratës në fushën e menaxhementit në Universitetin e Novi Sadit, ndërsa ka kryer studimet bachelor dhe master në Administrim Biznesi në Universitetin e Evropës Juglindore si dhe ka një master tjetër shkencor në Proceset Biznesore në Linnaeus University, Växjö – Suedi. Është bashëkautor i librit "Partners Selection and Performance Measurement in Supply Chain: A Survey of the Forestry, Manufacturing and Wholesale/Retail Industries in Sweden", LAP LAMBERT Academic Publishing si dhe një numër solid të punimeve shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore. Njërin nga punimet shkencore e ka të botuar në revistë të indeksuar në platformën Scopus. Gjithashtu kandidati ka dëshmuar përvojë në mësimdhënie universitare dhe menaxhim biznesi. Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidati i propozuar është më i përshtatshëm për këtë pozitë dhe ka përparësi në raport me kundër kandidatët.</p>
	<p>Abetare Prebreza</p>	<p>Kandidatja, PhD.Cand. Abetare Prebreza, nuk propozohet për këtë pozitë. Ajo i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare si dhe është duke vazhduar studimet e doktoratës në fushën e menaxhmentit në Universitetin e Prishtinës. Kandidatja ka disa punime të publikuara dhe disa pjesëmarrje në konferenca shkencore. Ajo ka qenë e angazhuar para dy vjetësh në Fakultetin Ekonomik për lëndë të tjera, por gjatë asaj kohe ka pasur probleme për sa i përket fleksibilitetit të orarit dhe angazhimeve tjera për të asistuar profesorët. Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidati i propozuar është më i përshtatshëm për tu angazhuar për mbajtjen e ushtrimeve nga këto lëndë.</p>
	<p>Kamer Brahimaj</p>	<p>Kandidati, PhD.Cand. Kamer Brahimaj, nuk propozohet për këtë pozitë. Ai i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Por, pas shqyrtimit të të gjithë kandidatëve dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se</p>

		kandidati i propozuar është më i përshtatshëm për tu angazhuar për mbajtjen e ushtrimeve nga këto lëndë.
	Erleta Halimi	Është propozuar në tjetër pozitë.
	Fatind Morina	Është propozuar në tjetër pozitë.
	Vjosa Hajrullahu Mustafa	Nuk ka marrë pjesë në intervistë.
	Lum Çollaku	Është propozuar në tjetër pozitë.
5. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët në semestrin dimëror: <i>Tregjet dhe Institucionet Financiare; Menaxhimi i Riskut dhe Sigurimet; Ekonomiksi Monetar.</i>	Erleta Halimi	Komisioni propozon që kandidatja, PhDC. Erleta Halimi, të zgjidhet për këtë pozitë. Kandidatja i plotëson të gjitha kushtet formalo juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Ajo ka qenë edhe vitin e kaluar e angazhuar në UKZ ku ka treguar sukses në mësimdhënie që është dëshmuar edhe nga vlerësimi i studentëve. Kandidatja ka mbaruar studimet master në Universitetin e Sheffield, si dhe është duke ndjekur studimet e doktoratës në Széchenyi István University of Győr në Hungari. Gjatë studimeve bachelor, kandidatja ka qenë përfituese e programit Erasmus Mundus Exchange Program ku një pjesë të studimeve ka mbaruar në Universitetin Ekonomik të Katovicës. Pas shqyrtimit të dosjeve për të gjithë kandidatët e paraqitur për këtë pozitë dhe pasi realizoi intervistat me kandidatët, Komisioni erdhi në përfundimin që kandidatja i plotëson kushtet më së miri që të zgjidhet në këtë pozitë.
	Arton Hajdari	Është propozuar në tjetër pozitë.
	Lum Çollaku	Është propozuar në tjetër pozitë.
	Artan Hajdini	Është propozuar në tjetër pozitë.
	Kamer Brahimaj	Kandidati, PhD.Cand. Kamer Brahimaj, nuk propozohet për këtë pozitë. Ai i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Por, pas shqyrtimit të dokumentacionit të të gjithë kandidatëve dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidatja e propozuar është më e përshtatshëm për tu angazhuar për mbajtjen e ushtrimeve nga këto lëndë.
6. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët në semestrin dimëror: <i>Ekonomia e Kosovës dhe Mjedisi i Biznesit; Ekonomia e Kosovës dhe Zhvillimi;</i>	Arton Hajdari	Komisioni propozon që kandidati, PhD.Cand. Arton Hajdari, të zgjidhet për këtë pozitë. Kandidati i plotëson më së miri kushtet për këtë pozitë, duke marrë për bazë kushtet formalo-juridike, për sa i përket notës mesatare si dhe fushës së studimit në studimet e doktoratës. Duke qenë se asnjëri nga kundër kandidatet nuk janë nga fusha e ekonomiksit, kandidati i është dhënë përparësi pasi ai ka në përfundim studimet e doktoratës nga fusha e

<p><i>Makroekonomi;</i> <i>Integrimet Ekonomike</i> <i>ne BE.</i></p>		<p>ekonomiksit në Universitetin e Evropës Juglindore, ku ka të përfunduara të gjitha provimet nga kjo fushë si dhe ka dy punime nga kjo fushë të botuara në revista të indeksuara në Scopus.</p> <p>Pas shqyrtimit të dosjeve për të gjithë kandidatët e paraqitur për këtë pozitë dhe pasi realizoi intervistat me kandidatët, Komisionin erdhi në përfundimin që kandidati i plotëson kushtet më së miri që të zgjidhet në këtë pozitë.</p>
	Erleta Halimi	Është propozuar në tjetër pozitë.
	Lum Çollaku	Është propozuar në tjetër pozitë.
	Artan Hajdini	Është propozuar në tjetër pozitë.
	Kamer Brahimaj	Nuk propozohet për këtë pozitë pasi nuk është nga fusha e Ekonomiksit.
<p>7. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët në semestrin dimëror:</p> <p><i>Financat e</i> <i>Korporatave;</i> <i>Financa</i> <i>Ndërkombëtare;</i> <i>Bazat e Kontabilitetit</i> <i>Menaxherial;</i> <i>Kontabiliteti i</i> <i>Institucioneve</i> <i>Financiare.</i></p>	Artan Hajdini	<p>Komisioni propozon që kandidati, PhD.Cand. Artan Hajdini, të zgjidhet për këtë pozitë. Kandidati i plotëson të gjitha kushtet formalo juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Krahas studimeve bachelor e master në këtë fushë si dhe atyre të doktoratës që është duke i vazhduar në Universitetin e Prishtinës, kandidati ka të kryera edhe kurse profesionale në fushën e kontabilitetit (SCAK). Ai ka qenë i angazhuar edhe vitin e kaluar si dhe në semestrin dimëror të këtij viti në Fakultetin Ekonomik dhe është treguar i suksesshëm në mësimdhënie.</p> <p>Pas shqyrtimit të dosjeve për të gjithë kandidatët e paraqitur për këtë pozitë dhe pasi realizoi intervistat me kandidatët, Komisionin erdhi në përfundimin që kandidati i plotëson kushtet më së miri që të zgjidhet në këtë pozitë.</p>
	Artan Hajdari	Është propozuar në tjetër pozitë.
	Erleta Halimi	Është propozuar në tjetër pozitë.
	Kamer Brahimaj	Nuk propozohet për këtë pozitë pasi nuk është nga fusha e Financave dhe Kontabilitetit.
	Lum Çollaku	Është propozuar në tjetër pozitë.
<p>8. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët në semestrin dimëror:</p> <p><i>Kontabiliteti Publik;</i> <i>Menaxhimi Financiar;</i> <i>Menaxhmenti bankar.</i></p>	Lum Çollaku	<p>Komisioni propozon që kandidati, PhD.Cand. Lum Çollaku, të zgjidhet për këtë pozitë. Kandidati është njëri ndër kandidatët që i plotëson më së miri kushtet për këtë pozitë, duke marrë për bazë kushtet formalo-juridike. Ai ka të përfunduar studimet bachelor dhe master në fushën e Banka, Financa dhe Kontabilitetit si dhe është në përfundim të studimit e doktoratës në të njëjtën fushë në Universitetin e Prishtinës. Gjithashtu kandidati ka një numër të punimeve të publikuara në revista shkencore ku 4 punime i ka në revista të indeksuara në Scopus.</p>

		Pas shqyrtimit të dosjeve të të gjithë kandidatëve të paraqitur për këtë pozitë dhe pasi realizoi intervistat me kandidatët, Komisionin erdhi në përfundimin që kandidati i plotëson kushtet më së miri që të zgjidhet në këtë pozitë.
	Artan Hajdini	Është propozuar në tjetër pozitë
	Erleta Halimi	Është propozuar në tjetër pozitë
	Mensur Ajeti	Kandidati ka marrë pjesë në intervistë por më vonë ka njoftuar Dekanatin se tërhiqet nga konkurrimi për arsye personale.
	Kamer Brahimaj	Nuk propozohet për këtë pozitë pasi nuk është nga fusha e Financave dhe Kontabilitetit.
	Fatbardha Gashi	Kandidatja ka marrë pjesë në intervistë por më vonë ka njoftuar Dekanatin se tërhiqet nga konkurrimi për arsye personale.


KANDIDATËT QË NUK I KANË PLOTËSUAR KUSHTET FORMALO-JURIDIKE

Nr.	Kandidati	Kushtet formalo-juridike që nuk i ka plotësuar
1	Rijade Maloku	Nuk e plotëson kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 2.
2	Xhejlane Behluli	Nuk e plotëson kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 2.
3	Vlora Sinani	Nuk ka të kryer asnjërin nivel të studimeve në ekonomi (BSc – Gjeografi dhe MSc – Juridik)
4	Meriton Ismajli	Nuk e plotëson kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 2.
5	Armend Limoni	Nuk e plotëson kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 2.
6	Kushtrim Qamili	Për pozitën e 1 nuk është i fushës kurse për pozitën e tjera nuk e plotëson kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 2.
7	Donika Aliu Zhuja	Nuk e plotëson kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 1 dhe 2
8	Merginë Halili	Nuk e plotëson kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 2.

Gjilan, më: 04.02.2024

Anëtarët e Komisionit:

1. Prof.Ass.Dr. Arben Sahiti – kryetar



2. Prof.Ass.Dr. Nexhat Shkodra – anëtar



3. Prof.Ass.Dr. Lulzim Rashiti – anëtar